



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 14 tetor 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1298_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 26 paragrafi 1, nenit 47 dhe nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e nenit 19 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 18 dhe nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike; dhe
- Kërkesën e Ndërmarrjes Publike – Ndrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos sh.a. të datës 12 gusht 2020, për shqyrtimin e të Hyrave maksimale të lejuara dhe tarifave të energjisë termike, bashkë me dokumentacionin relevant sqarues.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë 14 tetor 2020 nxori këtë:

VENDIM

- APROVOHEN** tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë të Ndrohtores së Qytetit (NQ) Termokos sh.a. për sezonin e ngrohjes 2020/2021, siç janë paraqitur në tabelën 'II.1', që do të zbatohen nga data 15 tetor 2020.

Arsyetim

- Me datë 12 gusht 2020 Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar Kërkesën nga NQ Termokos sh. a. për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe tarifave të energjisë termike.
- Për përcaktimin e të tarifave të energjisë termike, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet dhe shkresat relevante, si dhe takimet sqaruese që ka realizuar me NQ Termokos; dokumentet dhe shkresat relevante janë:
 - Të dhënat dhe informatat e dorëzuara bashkangjitur me Kërkesën për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe tarifave të energjisë termike, të datës 12 gusht 2020;
 - Komentet me shkrim lëshuar nga ZRRE me 28 gusht 2020, ku janë specifikuar kërkesat për korigjim, përmirësim dhe plotësim të të dhënave dhe informatave të dorëzuara bashkangjitur me kërkesën e datës 12 gusht 2020;
 - Të dhënat dhe informatat e korigjuara dhe të plotësuara sipas komenteve me shkrim të ZRRE-së, ri-dorëzuar nga NQ Termokos me datë 04 shtator 2020;



- Raportin për Konsultim Publik: Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Termokos – sezoni i ngrohjes 2020/2021;
 - Komentet me shkrim të pranuar gjatë periudhës së konsultimit publik (21 shtator – 05 tetor 2020);
 - Përgjigjen e ZRRE-së ndaj komenteve me shkrim të pranuar gjatë periudhës së konsultimit publik;
 - Raportin Final: Përcaktimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Termokos – sezoni i ngrohjes 2020/2021; dhe
 - Raportin final për Përcaktimin e Tarifave të Energjisë Termike për NQ Termokos – sezoni i ngrohjes 2020/2021.
3. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Termokos sh.a., për sezonin e ngrohjes 2020/2021 është dhënë në tabelën II.1 më poshtë:

Tabela II.1: Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Termokos sh.a. – sezoni 2020/2021

TARIFAT E ENERJISË TERMIKE TË NQ TERMOKOS - Sezoni 2020/2021			
A: TARIFAT E ENERJISË TERMIKE ME MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Vlera	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. fikse)	[€/kW/muaj]	0.78	
Tarifa për Furnizim /Konsum të En. Term. (Komp. variable)	[€/MWh]	36.25	
B: TARIFAT E ENERJISË TERMIKE PA MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Konsumat. shtëpijak	Konsumat. Kom&Inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m ² për muaj]	0.11	0.14
Tarifa për Furnizimin /Konsumin e En. Term. (komp. variable)	[€/m ² për muaj]	0.65	0.81
Tarifa totale për konsumatorët pa matje	[€/m ² për muaj]	0.76	0.95

- III. Duke marrë parasysh gjendjen aktuale lidhur me matjen e furnizimit / konsumit të energjisë termike, tarifat e përcaktuara në tabelën II.1 zbatohen për faturim për rastet tipike si në vijim:
- 1) Për objektet, nënstacionet e të cilëve janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike, dhe që janë në pronësi ose në shfrytëzim të një konsumatori, për faturim zbatohen tarifat me matje – Tabela II.1 A
 - 2) Për objektet e banimit kolektiv që janë në pronësi ose në shfrytëzim të disa konsumatorëve, nënstacionet e të cilëve janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike dhe instalimet e brendshme të ngrohjes qendrore në objekt mundësojnë matjen e konsumit në nivel apartamenti, për faturim zbatohen tarifat me matje – Tabela II.1A.
 - 3) Për objektet, nënstacionet e të cilëve nuk janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike, dhe për objektet e përshkruara në pikën (2) në të cilat instalimet e brendshme të



ngrohjes qendrore pamundësojnë matjen e konsumit në nivel apartamenti, për faturim do të zbatohen tarifrat "normative", sipas sipërfaqes ngrohëse të konsumatorit, – Tabela II.1 B.

- IV. NQ Termokos sh.a. duhet ta publikoj strukturën e tarifave të energjisë termike siç është përcaktuar në tabelën II.1 të këtij Vendimi, brenda pesë (5) ditëve të punës pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim më të gjerë në Kosovë.
- V. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Termokos, për të verifikuar realizimin e të dhënave të paraqitura nga NQ Termokos.
- VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga NQ Termokos nga data 15 tetor 2020 gjer në shqyrtimin e ardhshëm tarifor; ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së,

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejrija, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Bashkangjitur: Raporti Rregullativ: Përcaktimi i tarifave për NP Termokos sh.a. – sezoni i ngrohjes 2020/2021

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së